



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:017094
Datë: 23.07.2018
Numri i dokumentit: 00086483

P.nr.493/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Diana Sina, me procesmbajtësen Lamije Kuqi – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. G. nga fsh.R. K.Gjakovë, dhe kundër të akuzuarit A. A. nga fsh.K. e v. K.Prizren, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, të vjedhjes së rëndë në tentativë, nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP/II.nr.445/2017, të datës 26.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datën **26.06.2018**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj, të akuzuarve, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1.I akuzuari A. G., nga i ati I. dhe e ëma H. e gjinisë K., data e lindjes ... në fsh.R. K.Gjakovë, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, i martuar-atë i 2 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

2.I akuzuari A. A., nga i ati A. dhe e ëma Z. e gjinisë Be., data e lindjes ... në Prizren, e tani me banim në K. të V. K.Prizren, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

Sepse: Me dt.24.03.2017, rreth orës 19.30 minuta, në ish objektin M. në Gjakovë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të sendit të huaj, me qëllim fitimi, pasi më parë janë marr vesh ndërmjet vete dhe i kanë ndarë rolet, tentojnë që të marrin sendin të dëmtuarës ish M., në atë mënyrë që pasi kanë hequr dy profile metali nga kulmi i objektit të fabrikës, më pas i kanë bartur me kamionin e firmës “D. D.” ashtu që ende pa u larguar nga aty të akuzuarit janë zënë nga Policia duke ia konfiskuar të njëjtëve, pastaj profilet që i kishin tentuar për ti vjedhur.

Me çka kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje, të vjedhjes së rëndë në tentativë, nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së,.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46,50,51,73, dhe nenit 327 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës.

G J Y K O N

Të akuzuarin **A. G.** dënim me gjobë në shumë prej **100 (Njëqindë) Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2(dy)vite**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **3(tre)vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të akuzarin **A. A.** dënim me gjobë në shumë prej **100 (Njëqindë) Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2(dy)vite**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **3(tre)vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **5 (Pesë) ditësh**, për secilin veç e veç, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **30 Euro**, secili veç e veç, e krejt këtë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara Përfaqësuesi i autorizuar i ish Fabrikës M. në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.445/2017, të datës 26.07.2017, kundër të akuzuarve A. G. nga fsh.R. K.Gjakovë, dhe A. A. nga fsh.K. e v. K.Prizren, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, të vjedhjes së rëndë në tentativë, nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së, Prokurori i shtetit Armend Zenelaj në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuari A. G. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë dhe premtoi se në të ardhmen nuk do ta përsërisë të njëjtën, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam punëtor fizik herë pas herë kur ka punë, jam mbajtës i familjes si dhe për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysht rrethanat e lartë cekura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I akuzuari A. A. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës se veprën e tillë nuk do të përsërisë, shton se jam i pa punë, me gjendje të dobët materiale, për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer

penale por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë cekura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që të akuzuari kanë pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Në tërësi u vërtetuar se të akuzuarit A. G. dhe A. A.: Me dt.24.03.2017, rreth orës 19.30 minuta, në ish objektin M. në Gjakovë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të sendit të huaj, me qëllim fitimi, pasi më parë janë marr vesh ndërmjet vete dhe i kanë ndarë rolet, tentojnë që të marrin sendin të dëmtuarës ish M., në atë mënyrë që pasi kanë hequr dy profile metali nga kulmi i objektit të fabrikës, më pas i kanë bartur me kamionin e firmës “D. D.” ashtu që ende pa u larguar nga aty të akuzuarit janë zënë nga Policia duke ia konfiskuar të njëjtëve pastaj profilet që i kishin tentuar për ti vjedhur.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallën fajtor dhe të i gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: gjendjen e dobët ekonomike të tyre, pranimin e fajit, pendimin e tyre të thellë për veprën e kryer, premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprën e tillë apo të ngjashme, sjelljet korrekte të tyre gjatë gjykimit, e sidomos faktin se për herë të parë janë ndesh me ligjin, për herë të parë kanë kryer një vepër penale, në bazë të këtyre Gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, komfor nenit 28 dhe 75 par.1 nën par.1.2 të KPRK-ës, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata murr rrethanat në të cilat është kryer vepra, motivet për kryerjen e veprës, andaj Gjykata të njëjtëve iu shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej **100 (njëqind) Euro**, secilit veç e veç të cilën dënim janë të detyruar që ta paguajnë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2(dy)vite**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës së verifikimit në afatin prej **3(tri)vite**, nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, personalitetin e tyre, dhe se ky dënim i shqiptuar ndaj tyre do të arrij qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6, lidhur me nenin 453 të KPPK-se.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.493/17 me datë 26.06.2018

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.